

8JH-1

1976

SAMI MILLOSHI



Dafinë e ditës

Poezi

841.1
1176.

SAMI MILLOSHI

●
Dafinë
e ditës
●

Poezi



SHTËPIA BOTUESE
«NAIM FRASHËRI»

NUK DO TË PRES

Nuk do të pres që shiritin e përvurimit të pranverës ta presin dallëndyshet nesër me sqep, do të nxitoj sot, t'i pëshpëris molles fjalë dashurie e molla për mua të shpërthejë sythat; do të nxitoj ta bind lumin si djalin tim e lumi për mua të ngjitet në kodra, në male, e lumi për mua t'u qepë shkrepave kostum të gjelbër, do të nxitoj ta bind diellin të agojë më herët, të perëndoje më vonë e dielli për mua ta shtojë një tubë rrëzesh si babai për nipërit, e unë me to të thur një kurorë të praruar përfushat, për të dashurit.

Nuk do të pres urbanin të udhëtoj për në punë, do të zgjohem pa aguar t'i hip kalit të erës e kali i erës të trokojë në ato shtigje ku s'ka gjurmë të tjera.

*Nuk do tē pres tē kthjellohet qielli nga retē,
do tē zgjas krahët t'i pérzë e yjet nē duar
t'i marr,
e yjet ju t'jua vë nē tryezë si abazhurë...
Nuk do tē pres që nē mbledhjen shekullore,
tē shndérrohem nē mit, tē zë një kryevend,
do tē nxitoj sot tē them atë fjalë që kam
ndér mend pér ju,
tē dashurit e mi,
do tē nxitoj t'ju dhuroj hartën e vetvetes me
shkallë zvogëlimi
një me tre milionë.
Do tē nxitoj tē var nē portmantonë e ditës
kapelen time tē punës tē zbardhur nga dielli,
kapelen time me strehë transparente prej
djerse,
do tē nxitoj
nuk do tē pres....*

ËNDERR E LIRE

*Se nga më vjen një zë, se nga më vjen një zë:
ndryje ëndrrën që ke për të ngritur një hid-*

rocentral

*atje ku të tjerëve s'u ka vajtur ndër mend,
mbylle në kafaz zogun e mendimit
për ta pushtuar zemrën e florinjtë të malit
krejt ndryshe ç'është pushtuar gjer më sot;
mos e hidh vështrimin larg përtej ditës, për-*

tej vtitit,

*hidhe si balonë, tërhiqe si fëmijë,
si fëmijë që përkujdeset të mos i ngecë nëpër*

çati...

*Se nga më vjen një zë, se nga më vjen një zë:
bëj një pus brenda vetes për ëndrrën që ke
për t'i stolisur horizontet me një penel të ri
që të tjerët s'e kanë përdorur,
ankoroje zërin tënd në atë mol,
ku edhe të tjerë e ankorojnë
që të jesh i sigurt si perëndi...*

*Se nga më vjen një zë, se nga më vjen një zë.
një zë që s'dua ta dëgjoj
në emër të gjakut,*

për hir të ëndrrës,
për hir të zogut të mendimit
jam njeri në majë të Olimpit...

Ty ta them ëndrrën pa drojë,
njeri i thjeshtë qafsh apo ministër,
ë ti më merr për krahу si nëna, si shoku.
e ty ëndrra ime të bën me flatra.
Ty ta them ëndrrën pa drojë
edhe në qoftë ëndërr e marrë.
Jam në viset e mia, jam nën qiellin tim
më ka hije shuplaka që m'ep toka,
siç më ka hije zogu i mendimit në fluturim.

U D H A

Ndoshta dikush ka menduar se duke u
mbyllur në zyrë
unë do të harroj drurët e fëmijërisë dhe
lumin tim,
dhe pyllin profesor dhe shpellën e lashtë,
gjithçka që më lidh si pejzat çdo ind.

Ndoshta dikush ka menduar se duke shkelur
mbi qilim,
unë do të harroj udhët e dhive dhe shkëm-
binjtë,
dhe arën dademadhe dhe erën e sertë
që si thikë më ngulet kur rrëzon kallinjtë.

Ndoshta, ndoshta, por, ju lutem, mos u
nxitonî,
në qoftë se kështu do të ndodhë vërtet,
atëherë po, urdhëroni zdrukthëtarin
të më bëjë një arkivol — pupël të lehtë.

DREJT MEJE VJEN NJË DJALE

*Drejt meje vjen një djale
me krahë muskulozë,
me sy zhbirues;
drejt meje vjen një djale
për të cilin unë nuk do të them kurrë
«Ai i binte maces me lugë,
kur unë kisha krahë muskulozë
dhe sy zhbirues».*

Drejt meje vjen një djale... .

R I T Ě M

*Krejt me hap të qetë erdha dje nga shtëpia
në punë,
po sot me atë hap s'më mjaftoi koha.
Ç'ka ndodhur vallë, ç'ka ndodhur me mua,
mos erdh pleqëria apo mos vallë u lodha?*

*Unë asnjë thinjë nuk e kam në kokë,
s'e kam kapërcyer as mezin e moshës
po hapat s'u matkan me thinja dhe vite:
Ç'i dhashë unë kohës, ç'i dhashë unë kohës?!*

*Po ngutem t'i bëj një transfuzion gjakut
me rreze drite dhe fjalë prej guri,
dhe krahët po nqutem t'i bëj akrepa ore
dhe zërin ta vë në një fole baruti.*

*Po nautem, po ngutem që grimcën e dheut
nuse ta bëj, një nuse të rrallë:
Ç'i dhashë unë kohës, ç'i dhashë unë vallë?*

KAM PRANË TË VËRTETËN

Krejt lakuriq e kam pranë të vërtetën
në gjinjtë e saj pi qumësht si fëmijë
dhe s'ngopem-sic s'ngopet njeriu me jetën
edhe po të më falë vjetë një mijë.

Ca njerëz për çudi, më kanë qëlluar në
mungesë, kur kanë dashur të më ndalin këtë qumësht
diellor, jam grindur me ta me muaj e vite
dhe plagë kam marrë si ushtar në kraharor.

Ca plagë i kam mbyllur në horizontin e
kaltër, të tjera ende i kam hapur si puset.
Asgjë s'më tremb, të gjitha do t'i mbyll
si nata e parë e dhëndurëve me nuset.

E KUJT I DUHET NJERIU QË HESHT?

-1-

Udhëtoj ndanë një copë toke të pambjellë
dhe ndalem si bujk i regjur me shpirt të
vratë, pëllëmbët i fus në dheun e vakët thellë
dhe kërkoj farë...

-2-

Dhe farën e hedhi q'trjo copë tokë të mos
heshtë po të zhurmojë siç zhurmojnë ujëvara
edhe të vishet me kostum të gjelbër
si fushat dhe malet kreshtëbardha.

Unë s'dua tënë kurrikënd të heshtë,
asnje njeri në rrugë, asnje zog në çerdhe,
as veten, as ty, as gjethen në vjeshtë,
as shkëmbin që pret ta għid nē portrete.

-4-

*E kujt i duhet njeriu që hesht
përballë njerëzve dhe sendeve që kërkojnë
fjalën
siç kërkon vajza e re të bëhet grua.
siç kërkon toka e pambjellë farën?*

-5-

*Heshtja e tij e sterilizon ditën,
për të mos u bërë kurrë grua me fëmijë,
heshtja e tij të vesh kostum manekini
edhe të ngrin në një vitrinë.*

-6-

*E kujt i duhet njeriu që hesht,
që hesht e bëhet si sallë bibliotekë
ku dëgjohet si shfletohen
fletët e zverdhura të librit të vetvetes?*

*Udhëtoj ndanë një copë toke të pambjellë
dhe ndalem si ju me shpirt të vrarë,
pëllëmbët t'i fusim në dheun e vakët, thellë,
dhe të mbjellim, o vëllezër, farë...*

K R O N O M E T Ě R

Në mesnatë e qortoj veten:
Sa kohë ke humbur, mor i gjorë,
nga dita
kur mund të gdhendje në mermer një fytyrë
njeriu,
krejt të panjohur, të përkryer si e ardhmja,
kur mund të mbillje në kopshtin e ëndrrave,
një ëndërr që t'i lëvrinte tokës
si ajo foshnja tremuajshe që godet barkun
e s'ëmës
me këmbë;
kur mund t'i dhuroje diellit miliarda ruaza
gjaku
e dielli të të thosh faleminderit, biri im.

Në mesnatë e bind veten: S'je vonë, mor i
gjorë,
për t'i kërkuar ndjesë ditës siç i kërkoje
ndjesë nënës
kur ishe fëmijë e përbalteshe me shokë.
Po dita, ah, dita, nuk është faltore,

*ajo ta p  rplas mallkimin eg  rsisht
si nj   n  n   q   'e braktis biri.*

*Nuk mburrem,
nuk mburrem se do t'i gjej sekondat e
humbura,
ato që më kanë ikur si shtojzovalle.
Veten e vë në peshoren e fjalës
ta jetoj sekondën sa mosha e tokës
ta kronometroj me një fije bari të blertë
të blertë në të gjitha stinët,
në të gjithë shekujt
prej pëllëmbës sime
prej pëllëmbës sate*

ZEMRA U FLET SHPATULLAVE

Asnjë varg s'kam shkruar gjer sot për
shpatullat
dhe shpatullat, eh, shpatullat kurrë s'më
janë ankuar,
kurrë s'më janë mburrur:

Ti, moj zemër, q'u thur kaq ditirambe syve,
flokëve të së dashurës,
duarve të regjura dhe ballit të menduar,
ti që mburr qershítë e buzëve
dhe vetullat si fiskajë
si nuk u kujtovë për ne
të urtat shpatulla — hamej të kohës?

O shpatulla që nuk i luteni si lypsare dorës
së djathtë,
të marrë stilografin e të shkruaj një varg
për ju,
e di që keni filluar të kërruseni,
e di që fishkeni nga pak,
po kockën e keni djaloshare
që kohën si të dashurën e mbart.

TË BUKURËN E DHEUT E MARR PËR DORE

*Shokët e mi që pranë e larg ju kam,
faleminderit, faleminderit.*

*Asgjë s'më dhatë me kredi,
as fjalën e mirë,
as qortimin,
as flatrat,
as fluturimin.*

E unë të gjitha, të gjitha dua t'jua kthej.

*Të bukurën e dheut e kam marrë për dore
i kreh flokët,
i stolis mantelin,
e puth në gushë,
i bie në gjunjë
të Bukurës së Dheut PUNE.*

COPËTIMI I KAFAZIT TË NERVAVE

*Dhe përsërita të njëjtat fjalë që më tha
eprori,
asgjë nuk u shtova,
nuk u pakësova asgjë,
me indiferencë më panë rrugët,
të akullt më folën shokët.*

*Sot sërish eprori më tha diçka për ju
e unë për ta ballsamosur papagallin e futur
tinëzisht në korijen e shpirtit,
copëtova kafazin e nervave të mia,
ringrita çerdhen për zogun e mendimit,
për të mos humbur mallin që kam për rrugët,
prushin e fjalës së shokëve
dhe vetë rrezet e agimit.*

KËRKOJ NJË SEKRET

*Sa zili e kam njeriun e etur për udhë,
atë që lë gjurmë që s'mund t'i shuajnë
stuhitë,
atë që udhëton përditë, atë që udhëton
përditë.
Atë që kurrë s'i ka numëruar këpucët që ka
grisur,
atë që përzë nga vetja kënetën e ujit të
ndenjur,
atë që pi ujin e gurrave të bjeshkëve
si kulloshtër përtëritëse, si kulloshtër
magjepsëse.
Sa zili e kam njeriun e etur për udhë
i qepem pas të mësoj sekretin e lënies së
gjurmëve,
sekretin e vështirë që s'ngjan me mësimet
shkollore,
sekretin e lashtë, që kockat t'i bluan
ta vështrosh si fodull nga majë e posteve.*

*O njeri i mirë që të kam zili për gjurmët
në udhë,
nuk të lutem si perëndisë për sekretin e
vështirë,
të ndjek pas si i eturi për ujë
një gjurmë ta vë me hapin tënd të lirë.*

NË KOHËN E GJAKMARRJES

*Brenda mureve të kullës
lëvistejeta,
e gjakosur me plumb,
e serta,
erëshkrumb.
Toka mbeti djerrë
pa lëruar,
burri merrte frymë
me varr në duar.*

NUK E KAM PASUR TË LEHTË

*Nuk e kam pasur të lehtë të harroj ato
krisma pushke
që më përgjysmuani fisin për një pëllëmbë
tokë,
më është dashur të mbaj male mbi supe
gjersa nipërve të gjakësorëve t'u them shokë.*

*Nga shpellat e thella të kanunit të lashtë
një zë më ka qortuar: «Mos u thuaj shokë,
se të parët e fisit do të ngrihen nga varri
dhe pastaj ku do të shkosh ti, mor i gjorë.»*

*Nuk e kam pasur të lehtë t'i harroj ato
krisma pushke
dhe ato kafe që m'i dhanë me tabak nën
gjunjë,
më është dashur t'i latoj trajtat e shpirtit,
që krismë gjakmarrjeje të mos fshehin kurrë.*

*Po pse, po pse vallë me një fytyrë të
përtërirë
dikush m'i rikrijon ato krisma ogurzeza,*

*kur fjalën e çlirë ma qëllon me plumb
dhe nuk i dridhet dora, dhe nuk i dridhet
zemra?*

*Nuk e kam të lehtë t'i harroj ato krisma
pushke
që ma përgjysmojnë ditën që kam për të
jetuar,
më duhet të mbaj fushat në pëllëmbë
dhe në pëllëmbë të lindet fara e uruar....*

*Nga shpellat e thella të kanunit të lashtë
sërish, sërish. më qorton një zë:
«Braktise atë aë ditën ta çart
dhe shpirtin si toka pa pyll ta lë!»*

*Po unë këtë zë që vjen nga shpell' e lashtë,
s'mund ta dëgjoj, e mbysin sirenat,
se krahët e mi i kam shtruar si shinat,
kaloni, o njerëz të mirë, si trenat. . .*

KËNDOJ ME ZOGJTË NJË KËNGË AKAPELO

*Agjencia e thashethemeve
një lajm dha sot,
sipas të cilit unë
do ta lë këtë post.*

*Me vrullin e erës
tek unë mbërriti lajmi
a thua u përhap
me linjë teletajpi.*

*Dhe unë atë çast
ndeza një cigare
dhe nisa t'u rrëfej
zogjve këto vargje*

*Dhe zogjtë që këndonin
akapelo në kor
e pëlqyen zërin tim,
më morën për tenor.*

*Dhe kënduam tok
mbi pullaz të thashethemeve
këngën e lashtë
të ngritjes së foleve.*

*Dhe rendëm dhe rendëm
tërë ditën mbi qytet
pranvera i shpalli
këto vargje me teleks...*

POR TA E SHTËPISË SIME

Nëna më tha: «Hape, bir, portën,
të ka ardhur një mik i mirë.»
E unë për mikun mora tabakanë
e mbi të vura zemrën,
e mbi të vura kokën.

Nëna më tha: «Bir, mos e hap portën,
se po të vjen një gjarpër rrotull.»
E unë për gjarprin
shkula një eshtër nga trupi
dhe e bëra lloz për portën.

Portë e shtëpisë sime
me lloz prej eshtrash,
me prag prej gjaku.

T H I R R J E

*Djepi im është i etur për foshnja,
djepi im i lashtë, i lashtë sa bota.
Ja djali në djep thërret:
Unë u ngrita më këmbë!
Unë mora malet përpjetë,
mos e lini djepin të heshtë!*

NË PËLLEMBËN TIME RRITET NJË LIS

*Evropë, moj Evropë,
me arkiva të shkëlqyer.*

*Unë kam stërgjyshin arkiv të gjallë,
miliona herë më i shkëlqyer
se arkivat e tu.*

*Kam gjyshin dhe babanë,
jam vetë me gjithë djalë,
me nipërit
dhe stërnipërit që ende s'i kam.*

*Stërgjyshi im me kujtesë të mahnitshme,
sa herë i lutem ngrihet nga varri
dhe më thotë nga cikli i kreshnikëve
atë varg që e kam harruar...*

*Dhe biri im,
i vogëlthi djalë që përkundet në djep,
gjysma-gjysma fjalët i flet,
po dihatjen e ka si të Mic Sokolit;
e unë besoj se nga djepi po çohet
të rimbyllë një grykë topi.*

*Europë, moj Europë,
me arkiva të shkëlqyer.
S't'i kam zili arkivat e tu
as stérnipërit që do të vijnë s'do t'i kenë zili.
Në gjoks të tyre do të rrojë fara e legjendave,
në pëllëmbë të tyre do të rritet
lisi shekullor i besës,
në pëllëmbë të tyre do të gatuhet
buka e lirisë
e papjesëtueshmja me kurrkënd.*

*Europë, moj Europë,
me arkiva të shkëlqyer.
Farën e legjendave të mia
dhe lisin shekullor të besës,
bukën e lirisë
dhe sytë e tim biri
s'i nxënë arkivat e tua
sic nuk e nxënë arkivat — Diellin.*

*Jam djep i stërgjyshërve,
jam djep i stérnipërve.*

PLAGËT E LUFTËS

*Eshtë shtrirë ai burrë
mbi rërën e bregdetit
me plagët e luftës
përkundruall diellit.*

*Dhe nuk thërret
asnje njeri
që të shohë plagët
e trupit të tij.*

*Sa e pagtë dita,
sa e butë rëra
nën plagët e luftës
që buçasin të tëra...*

FJALORI I GJUHËS SHQIPE

O libër i madh i lashtë si stërgjyshërit,
o libër i madh i gjuhës mëmë,
unë para teje jam fëmijë i urtë,
që kokën në prehër ta kam vënë.

Fytyra ime në prehrin tënd merr ngjyrë,
në prehrin tënd merr trajtë gjaku im,
prej fjalëve të tua përbëhen kockat e mia,
prej dritës së tyre më merr syri shkëlqim.

Shumë fjalë të huaja kam nxënë në këtë
botë
nga librat e mëdhenj — stërgjyshër të
popujve të tjerë,
po kurrë s'më ka shkuar mendja t'i bëj çiflig
për ty,
se ti je vetë minierë floriri e thellë.

Po kur një dorë tinzare fjalën time-bijëz
ka dashur ta martojë me prapashtesa të liga
unë, biri yt, o stërgjysh i lashtë,
ripërgjakem me bajlozin si Gjergj Elez Alia.

*Pér një fjalë tënden si pér një pëllëmbë tokë,
pér një fjalë tënden si pér një copë qìell të
kaltër,
nipér e stërnipér që do të vijnë në shekuj,
kokën duke qeshur do ta vënë në satër...*

VAJTIM I NËNËS . . .

*Ti je gur që rëndon në vend të vet,
o biri im,
edhe i gjallë
edhe i vdekur,
o biri im.*

*Ti je lis që s'e shkru mbojnë rrufetë,
o biri im,
edhe i gjallë
edhe i vdekur,
o biri im.*

*Ti je djep që s'rresht së përkunduri,
o biri im,
edhe i gjallë
edhe i vdekur,
o biri im.*

*Djep i gurtë,
lis i gurtë,*

*gur që rëndon në vend të vet
të ka nëna
edhe të gjallë
edhe të vdekur,
o bir.*

MJESHTRAT E BARUTIT

*Gryk' e pushkës donte barut,
të ish i nderuar flâmuri në shtizë,
dhe ngjishte stërgjyshi gjurgjylen ngamot,
gatuante si bukë, lirinë në dingë.¹⁾*

*Te dinka i kish dirsur mustaqja stërgjyshit
te dinka pastaj u thinj ai,
te dinka i heshti zemra një ditë,
te dinka përplot me barut të zi.*

*Heshti një zemër prej mishi e gjaku
po zemra e dingës nuk heshti kurrë,
u bë im gjysh dingëtar i mbaruar
dhe ati më pas te dinka u bë burrë.*

*Ca armë të turpëruara trofe,
përkrah i rrjinë dingës që s'ka heshtur,
që veç maketin ka në muze
po vetë është në shpirtin tim të ndezur.*

1) Dinga: kështu i quante populli i Matit punishtet e barutit.

MASAKRAT NË DIBËR MË 1913

*Para nënës e shpuan foshnjën
mu në zemër me bajonetë,
të mbetej djepi pa përkundur
edhe shtëpia krejt e shkretë.*

*Dhe zjarrin djepit ata i vunë,
i bënë hi lulet e gdhendura,
dhe burrit plak ia prenë gjuhën,
të mbetej shqipja pa legjenda.*

*Vajtojcat burrat i vajtuan,
vajtojcat çorën edhe faqet,
çurkuau lotët përmbi plisa
e çelën prapë manushaqet.*

*Dhe rroi fara e legjendës
edhe mbiu në gjoks të burrit,
dhe hapi krahët si shqiponja
përmbi gjakun e flamurit.*

*Nata binte erë shkrumb,
nata binte erë gjak,
vështron te hëna si shpërthente
nga shkëmbinjtë një zambak.*

VËSHTROJ QIELLIN E KALTËR

*Ju që më akuzoni
me fjalën i vetmuar
dua t'ju bind
për të kundërtën e saj.
Po me çfarë t'ju bind,
me çfarë t'ju bind vallë?*

*Ngrita kokën lart dhe vështrova qiellin e
kaltër,
të kaltër si sy fëmije,
dhe pastaj ula kokën poshtë,
këputa një fije bari të blertë,
të blertë në të gjitha stinët.*

*Më tepër ç'doni,
ç'doni më tepër?*

UDHËTAR I HUAJ

*Kam shtruar një sofër për udhëtarin e huaj,
një sofër bujare me mjaltë shpirtrash
njerëzorë,
dhe them me vete i lumi Bajron
që herët e shijoi këtë mjaltë përrallor.*

*O udhëtar i huaj që s'i di ligjet e kësaj toke,
në këtë sofër bujare me mjaltë shpirtrash
njerëzorë
asgjë të shtruar mbi të s'e kam hua
siç nuk i kam hua eposet në folklor.*

Mirë se të vish, mirë se të vish. . .

FYTYRË QË I BINDET RREZES
SË DIELLIT

*O njeri që ke marrë një daltë në dorë
dhe në fytyrën time kërkon të għħendesh një
profil tē tjeterrsuar,
je tepér vonë, je tepér i vonuar.*

*Unë jam gjysh,
jam dhe djalosh,
je tepér vonë,
je tepér i vonuar.*

*Në do värtet tē pērkryesh profilin tim
merr një rreze dielli në dorë në vend tē
daltës
me tē djaloshin e bën gjysh
dhe gjyshin djalosh e bën brenda natës.
O njeri!*

BUKUROSHI IM. DESH MË IKE. . .

*Dielli më tha: gjithçka rreth teje e shoh,
ta shoh edhe kopsën e këputur të këmishës,
edhe tufën e thinjave te tëmthat,
edhe dridhjen e duarve nga tensioni i ulët!
Po mos prit që edhe kopsën të ta qep unë
me rrezen time,
mos prit që tufën e thinjave të ta ngjyej
me penelin tim
dhe sidomos mos prit
që të ta ngre tensionin
duke të marrë në prehrin tim
e duke të të nanurisur me përralla për
galaktikat
që mezi të pritkan ty.
Dhe unë diellin e pashë në sy
e s'i mora mëri.
e nisa të qep kopsën e këputur të këmishës,
me një krëhër të drunjtë
nga druri i fëmijërisë sime,
kreha thinjat që desha t'i fsheh me bojë
kimike*

*dhe mëngjesin nisa ta ha rregullisht.
Dhe dielli më pa,
dhe dielli më tha: të bëftë mirë,
bukuroshi im, desh më ike...*

ËSHTË NJË NJERI QË GËRMON NË MUA

*Eshtë një njeri që më gërmon si arkeolog
në shekullin e gjyshit dhe në thinjat e babait,
i etur, i etur të gjejë një fosil
një fosil-njollë që jetoka në mua.*

*Eshtë një njeri që më gërmon si arkeolog
Dhe s'jen kurrgjë në shekullin e gjyshit
dhe s'jen kurrgjë në thinjat e babait.
Më gërmon me sondë moshën time,
më mat me milimetra hapat e mi
të gjejë një fosil fajji.*

*Hiqmu sysh, o arkeolog i mjerë,
unë të rrëfej vetë: dje bëra një gabim;
unë të rrëfej vetë: sot bëra një tjetër
e nesër mund të bëj një tjetër...*

*Hiqmu sysh, arkeolog dështak,
unë të them vetë:*

*jo të gjitha hapat i kam të saktë si teoremat
e Pitagorës,
jo të gjitha fjalët i kam të latuara si qoshet
e kullës,
po ty s'të lë të më sharrosh këmbët
që unë të eci me paterica rrugës.*

KAM PASUR NJË SHOK

*Kam pasur një shok që nënën e tij
një herë në vit e shihte në fshat,
dhe thosh: «U mbyta në punë»,
dhe ndërronte çdo ditë kravatë.*

*Dhe shahej me kamerierin çdo ditë
pse nuk i sillte biftek, po bidok;
nëna atje në fshat
për djalin kuvendonte me zogjtë.*

*Eshtë bërë i madh i thoshin zogjtë,
është bërë i madh, shëtit me veturë.
Ah, more zogj të dashur, thosh nëna,
burrë kur do të bëhet, kur?*

*Ah, more zogj të dashur,
ah, more zogj të mirë,
mos ma gjen gjë djalin,
vallë rrëzohet me makinë...*

*Kam pasur një shok që nënën e tij,
një herë në vit e shihte në fshat,
dhe thosh: «U mbyta në punë»,
dhe ndërronte çdo ditë kravatë.*

E URTA, E SERTA

*Ti shpesh më thoshe: «Eshtë koha për t'i
shërbyer vetvetes!»*

*Dhe vërtet me një mundim prej Sizifi
nqrije gurët e rëndë të meritave të fisit
dhe të vetes... .*

*Mua më dukej se me dekoratat e fisit
ti çdo ditë hapje një panair të vogël,
të vogël sa një gogël.*

*Jashtë goglës është bota e të tjeraeve
e urtë si një nënë e dhembshur,
q'asku jt nuk i mburret me ç'bëri për fëmijët.*

*Ti shpesh më thoshe: «Eshtë koha për t'i
shërbyer vetes,»
dhe unë me ty grindesha si guri me gurin,
dhe unë të thosha: «Mos u bëj dado e mjerë,
dado e mjerë që përkund në djep burrin.»*

*E ç'vizitorë të erdhën në panairin e vogël
të dekoratave të fisit dhe të lavdeve për
veten?*

*Ah, po, t'erdhi proverbi i popullit
«Mendjemadhësia vjen shaluar dhe ikën në
këmbë».*

*Jashtë panairit tënd të vogël
është bota e madhe e të tjerëve,
e drejta, si një nënë e dhembshur
q'asnijërit prej fëmijëve s'i bën privilegje...*

FQINJI IM

*Fqinji im ka kujtesë të mrekullueshme;
sipas urdhrit të gruas nuk harron çdo ditë
të blejë çokollata të mëdha sa fletorja
për fëmijët.*

*Fqinji im ka kujtesë të mrekullueshme;
sipas urdhrit të gruas nuk harron ngahera
t'i mbushë çantat me sende të rralla,
kur ktuhehet nga shërbimet në zonat e thella.*

*Fqinji im vetëm në pak caste harron,
për shembull në çastin,
kur duhet të të pyesë pér shëndetin,
pér shembull në çastin,
kur duhet të bëjë një telegram ngushëllimi;
pér shembull në çastin,
kur duhet të mbushë borsën me ujë të nxeh të
pér këmbët e mëmës që i ther reumatizma...
Pér shembull në çastin,
kur lë dritën e zyrës ndezur*

*dhe në çaste të tjera,
të tjera me mijëra...*

*Fqinji im ka kujtesë të mrekullueshme,
fqinji im — harrim i vetvetes.*

PROFECI PËR TIM BIR

*Unë s'jam profet, o biri im,
po dua të bëj një profeci,
që ti do të bëhesh djalë me nam,
shkencëtar me famë kush e di...*

*Dhe ndoshta lulet do të rrrethojnë,
o biri im, me madhështi,
atëherë ti mua më kujto,
kujtomë në malet me sharki.*

*Në ndodhtë të mos më kujtosh mua
për hir të luleve të botës,
do t'i bëj zë Naimit
të të mallkojë me dhjetërrorkësh.*

*Ti mund të mbetesh njeri i thjeshtë,
pa famë, pa nam e pa lavdi,
po ja që unë ta kam borxh
si ati yt këtë profeci.*

MOS M'U NGJIT

*Mos m'u ngjit si rrinqna në kurrizin e deles,
mos m'u ngjit të më pish gjakun me lajka,
unë gjakun e kam për punë të mëdha
dhe ty nuk ta fal për punë të mbropshta.*

*Se unë e di pse më fut krahun në bulevard,
se unë e di pse më dhuron komplimente,
mos kujto se jam apartament
që nuk bëj dot pa suvanë tënde.*

*Unë mund të eci gjithë ditën nëpër shi
dhe të më shijojë lagia e shiut si buka e
ngrohtë,
mjaft që nën çadrën e lajkave të tua
të mos jem qoftë dhe një sekondë.*

P A G J U M Ě S I

*Paskam kaluar një ditë me veturë
e shokun e fëmijërisë s'e paskam vënë re në
udhë,
vetëm nga moskthimi i kokës djathtas një
çast
atë tërë natën e paskam lënë pa gjumë.*

*Mos ndoshta mua më paska ngrirë qafa
nga ndonjë spondelit me origjinë sediljeje
prej së cilës të nxihet faqja?*

DITA MË QËLLON ME PËLLËMBË

*Dikush tha se në atë zyrë,
dikush tha se atë karrige
«mund ta zbukurojë vetëm tymi i llullës së
tij,
dhe vetëm prapanica e tij,
prapanica e ngjallur me mish orësh të
vdekura...»
Dhe unë përsërita: «tymi i llullës së tij,
prapanica e ngjallur e tij...»*

*Dhe unë pa dashur krijova një mit
për të cilin më akuzojnë rrugët,
dhe muret e pafajshme të zyrës së tij
dhe shokët dhe tryeza e bukës.*

*Krijimi i miteve nuk paska mbaruar,
dita më qëllon me pëllëmbë
për mitin që krijova.*

N D E R I

*Unë s'kam ndër mend të qeras një nëpunës
të velur,
ta pres në rrugë dhe t'i dhuroj një buzë-
qeshje,
vetëm që ai për dy dhoma e një kuzhinë
të firmosë një shkresë krejt të pandershme.*

*Se më ngjan dhe përrallën e Kësulëkuqes
së prapthi ia kallëzoj vajzës trevjeçare;
si mund të them se bora është e zezë
dhe gjaku është i bardhë si borë bjeshke?*

*Po të më thyhei mua shtylla kurrizore
dhe vajza së prapthi t'i mësonte përrallat,
catia e shtëpisë do të binte mbi kokë,
dhe shkresa e pandershme si qefin mbi
qepallat.*

PËR SHOKUN

*Ah sa finoke është kjo kameriere,
gjithnjë vëren kush i paguan kafet,
shoku im me post të lartë,
apo unë që vij të çmallem me të nga malet.*

*Unë s'dua të tregoj historira,
ç'kuleta kishim njëzet vjet të shkuara,
kur shoku im i kish këmishat
nga nëna ime të arnuara.*

*Dhe sot mos na vërej, pra, moj finoke;
mos na u fut si shemër në kuletë,
me njëri-tjetrin s'jemi bërë shokë në kafe,
për njëri-tjetrin lëmë kokën krejt të qetë.*

3

● Dafinë
e ditës

8

đoàn C

đoàn C

VETËM TI

*Mos e nis ditën pa një kafshatë bukë,
ja, pije një gotë qumësht,
haje dhe një kokërr vezë
se je për udhë...*

*Vetëm ti e di gjatësinë e udhës sime,
vetëm ti e di sekretin e lodhjes së gjunjëve,
Vetëm ti mund të më bindësh ta lë cigaren,
kryemjekja ime,
e shtrenjta nënë që kollitesh e kollitesh...*

K L O R O F I L È

*S'të ka mbetur asgjë prej vajze, e dashur,
klorofilën e gjoksit ta pinë dy buzë të njoma
fëmije që përkryem.
E ke vënë re sa rrallë
ia krehim njëri-tjetrit flokët me gishta si
dikur?
Po ç'them vallë,
mos lajthita,
po të mos ndodhte kështu
si do të bëhesha unë burrë?*

MBOLLA NJË QERSHI

*Unë mbolla një qershi,
gjithë merak,
dhe e mbroj nga acari
zemërak.*

*Gjer të rritet e të bëjë
kokrra plot
të gëzojë kalamanët
edhe zogjtë.*

*Unë vetë
asnë jë kokërr nuk dua.
Le të mos e dinë
kush e mbolli këtë pemë,
kur t'i gjelbërojnë
ajethet nërmbi krua,
kur në deaë zogjtë
të ngrenë folenë.*

VAJZA LOTON

*Në fletoren e bukurshkrimit të vajzës,
për shkak të cilësisë së keqe të letrës,
boja u bë njollë...*

Dhe mbi njollë ra lot i nxehthë.

*U prish një rresht me «a» të vogël,
u prish një rresht me «B» të madhe;
vajza s'pushon së qari,
shkronjat e kanë ndalur vallen.*

*C'të bëjmë, bijëz e dashur, ç'të bëjmë.
Të blejmë një fletore tjetër
apo t'i shkruajmë punëtorëve një letër?*

*Ti domosdo kërkon fletore të re,
ti nuk e di se c'është Partia,
Asaj i dhimbsen më parë se ne
kokrra e grurit,
vallja e shkronjave
të gjitha, të gjitha...*

HAP I LEHTË

*Rruga ma ndien hapin e lehtë sot,
dhe ma zbulon sekretin e dritës në fytyrë.
Një puthje e gruas duke u nisur për në punë,
dafinë e ditës.*

Q O R T I M E

*Mos u vono, më qortojnë shokët,
mos u vono për të prekur grimcat e dheut;
mos u vono, më qortojnë rrugët,
mos u vono për të shpënë lule te të rënët;
mos u vono, më qorton e dashura,
për të mbetur djalosh këtë shekull e përtej;
mos u vono, më qorton lumi,
për t'u bërë digë, ledh pritë;
mos u vono, më qorton mësuesja e klasës së
parë,
për të bërë një vjershë të harruar për të.
Mos u vono, më qorton nëna,
dhe nëna ndryshe nga të tjerët,
krejt ndryshe nga të tjerët,
më qorton me puthje,
më qorton pa zë.*

Ç A S T

*Iu rritën flokët djalit, i zunë sytë,
po hajt t'ia qethësh, s'e zë dot,
atëherë unë gjej një çast, kur ai
duke thithur gjirin, është dakord... .*

*Gërshëra pret majat e flokëve,
dhe zbulon ballin e madh të djalit,
dhe unë me vete rri e mendoj
për plugun që do t'i lërojë arën e ballit... .*

FUSHAVE TË KRUJËS

Më kanë mbetur në sy
fushat e begata,
Kruja si shqiponjë
me çerdhen në mal,
kuleçët e rënduar të luleve të diellit,
dhe shtëpitë e kredhura
mes pjergullash në radhë.
Unë s'mbaj me vete penela piktori
t'i ngjyej në këtë hapësirë,
po gjoksi gufon, sa s'cahet kraharori
të mbledhë aromën e mirë.
Me këto fusha të begata,
që më mbeten në sy,
do të më zërë gjumi sonte.
Më ngjan vetja si galeri arti
me peizazhe që do të zgjohen.

LIQENI I TETË I LURËS

*I brodha tërë ditën shtatë liqenjtë e Lurës
dhe thashë me vete: i teti je ti.*

Ku janë lulet e kuqe?

— *Më shih buzët.*

Ku janë lulet e bardha?

— *Më shih cipën e ballit.*

N Ė C I R K

*Kalorëse e vërtetë ti dukesh mbi kalë,
veç mos u mburr, s'është zotësia jote.
Ç'do të bëje ti, bijëz, sikur këtë cirk
elektriku të mos e rrrotullonte?*

*Që nga ky kalë prej druri i cirkut
e gjer të hipësh tek kali i vërtetë,
mos kujto, moj bijëz e dashur,
se do të të pres edhe atëher' biletë..:*

DHERAT E ËMBLA

*Unë i dua kodrat
për ato dhera të ëmbla,
për ato degë të buta,
për ato shkallë tarracash
si muzikë dallgësh,
që shkumën e bardhë
ma lënë në breg të zemrës
vjeshtës edhe verës
e dimrit me mjegull,
kur shpirti im rri varur
si vilet në pjergull
e rrënje më rrënje
pikon një lëng të mirë,
që lëvrin në trungje,
si gjaku në dejë,
e bëhet syth
e petale të bardha
e purpuron te pjeshka
si në mollzat e dashura...*

NË NJË DHOMË PUNËTORËSH

*Unë jetoj në një dhomë punëtorësh
me dy shokë në Veri,
e ndezim sobën me tallash,
kur bie borë dhe ka stuhi.*

*Saliu vesh peliken time,
kur kullon e vetja ujë,
kurse për mua nën' e tij,
po thur një triko me lesh rudenë.*

*Dhe pa u nisur për në pyll,
me capin dhe sharrë në dorë,
Rasimi çajin na e zien
dhe na mbush nga një gotë.*

*Një ditë patjetër do të ndahemi,
se s'do të jetojmë si beqarë,
po si vëllai për vëllanë,
malli shpejt do të na marrë.*

PËRCJELLJA E NËNËS

*Pesë vjet u bënë që nëna më përcjell,
te stacioni i autobusit për në Veri,
të shtunat më hekuros këmishët,
të dielat hutohet nëpër shtëpi.*

*Do të shkoj unë dhe ajo patjetër
do të bëjë për mua byrek të mirë,
dhe e fut në çantë ta marr me vete
e ta ha me shokët me dëshirë.*

*Një grusht me arra e fut në një xhep,
kurse në tjetrin vë një kokërr mollë.
Gjithmonë kur më përcjell vetja më ngjan
burrë dhe fëmijë që niset në shkollë.*

*Si s'u mërzit nië herë nga kjo përcjellje,
si nuk harroi një herë të më jepte diçka,
në kujdesin e saj gjithmonë kam besuar,
se nëna mua më nis në udhët e mëdha.*

FRYN NJË PUHI

*Frym një puhi
dhe grurin tund,
për një figurë
më vë në mund.
Të them se tundet
si vajzat kolonjare,
kur dridhen naziqe
ëmbël në valle.
Frym një puhi
si cule dyjare...*

NATË E BUTË PRILLI

*Kjo natë e butë prilli,
të deh me afsh të tokës,
mbi plis ta vësh kokën
e gjer në ag të çlodhesh.*

*Po nuk të lë meraku,
të djeg si gacë në gji,
se fara kërkon shtratin
si djepin një fëmi.*

*E nesër në agim
një thinjë e bukur shfaqet
nga ky merak njeriu
rinohet edhe s'plaket.*

SOT, PËR DITËLINDJE

*Sot vesha një kostum të ri
dhe prita urime për ditëlindje
nga shokët, miqtë, të dashurit.
Tërë ditën nuk pushoi zilja e telefonit
që ma përgjysmoi moshën mua
dhe nënës ia uli tensionin... .*

KUMBOJNË LODRAT

*Kur vjen vjeshta në Peshkopi,
dridhet gjeth i blirit e kumbojnë lodrat,
e dhëndri nuses gushën ia stolis
me një gjeth të artë këputur te kodrat.*

*Qyteti flë vonë qoftë dhe nga një dasmë
dhe oborret shtron me lulet e Lurës
si qilim lumjan endur me motive
krejt të ylberuara nëpër duar të nuses.*

FIROI LODHJA E DITËS

*Nuk e kisha ndër mend
të të telefonoja,
nga lodhja, thjesht nga lodhja.*

*Kthehesha nga arat e porsambjella,
që hëna e plotë i spërkaste në dritë.*

*Kur kryetngrita
dhe pashë hënën e plotë,
rrugës çuditërisht u ktheva në postë.*

*Po kur u ktheva nga posta
gjumi nuk më zinte,
firoi lodhja e kësaj dite.*

SHKRUAJ MBLAKULL EMRIN TËND

*Brenda në dhomë
akulli ka qëndisur. në xhame
lulet e dimrit.*

*Unë shkruaj me gisht
mbi këto lule
emrin tënd.*

LULET

*Ia shoh dorën e djathtë shokut,
gishtat që s'i binden radialit¹⁾) të dëmtuar
dhe them me vete: «Ç'të bëj unë,
ç'të bëj që të mos heshtë një penë,
që të mos këputet në mes një varg i
pambaruar?»*

*Këputa një tufë lule për shokun tim,
gishtat nuk mund të mos u binden luleve
në dorën e poetit, thashë.*

1) nerv.

PËRMBAJTJA

I Nxitoj ta bind lumen

Nuk do të pres	5
Endërr e lirë	7
Udha	9
Dreit meje vjen një djalë	10
Ritëm	11
Kam pranë të vërtetën	12
E kuit i duhet njeriu që hesht?	13
Kronometër	15
Zemra u flet shpatullave	17
Të Bukurën e Dheut e marr për dore	18
Copëtimi i kafazit të nervave	19
Kërkoj një sekret	20

II Nuk e kam pasur të lehtë

Në kohën e giakmarries	25
Nuk e kam pasur të lehtë	26
Këndoi me zogitë nië këngë akapelo	28
Porta e shtëpisë sime	30
Thirrie	31
Në pëllëmbën time rritet një lis	32
Plasat e luftës	34
Fjalori i gjuhës shqipe	35

Vajtim i nënës	37
Mjeshtrat e barutit	39
Masakrat në Dibër më 1913	40
Vështroj qielin e kaltër	42
Udhëtar i huaj	43
Fytyrë që i bindet rrezes së diellit	44
Bukuroshi im, desh më ikë	45
Është një njeri që gërmont në mua	48
Kam pasur një shok	49
E urta, e sarta	51
Fqinji im	53
Profeci për tim bir	55
Mos m'u ngjit	56
Pagjumësi	57
Dita me qëllon me pëllëmbë	58
Nderi	59
Për shokun	60

III Dafinë e ditës

Vetëm ti	63
Klorofilë	64
Mbolla një qershi	65
Vajza loton	66
Hap i lehtë	67
Qortime	68
Çast	69
Fushave të Krujës	70
Liqeni i tetë i Lurës	71
Në cirk	72
Dherat eëmbla	73
Në një dhomë punëtorësh	74
Përcjellja e nënës	75
Frym një puhi	76

Natë e butë prilli	77
Sot, për ditëlindje	78
Kumbojnë lodrat	79
Firoi lodhja e ditës	80
Shkruaj mbi akull emrin tënd	81
Lulet	82